

Dr. Mimoza KAÇI

Dr. Mimoza Kaçi, lindur më 15 Tetor 1978, është diplomuar në Universitetin e Ekonomisë dhe Biznesit në Vjenë, Austri, ku ka ndjekur studimet universitare dhe studimet master.

Zj. Kaçi është e specializuar në fushën e tregut të sigurimeve dhe tregjeve financiare.

Ajo mban titullin Doktor i Shkencave në fushën e financës dhe ka eksperiencë të gjatë pune në administratë publike dhe në fushën akademike.

Është kontribuese aktive në kërkimin shkencor nëpërmjet një sërë botimesh në fushën ekonomike, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

Zotëron shumë mirë gjuhët anglisht, gjermanisht dhe italisht.

Që prej datës 24 Dhjetor 2014, zj. Mimoza Kaçi mban pozicionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ajo është njëkohësisht anëtare e Bordit të AMF-së.